



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:131984

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05627525

C.nr.141/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, si civile në përbërje me gjyqtarin Hajrullah Aruqi, në kontestin e paditësve B.X. nga fshati..., komuna Skenderaj dhe L.R. nga fshati... komuna Skenderaj, të cilët i përfaqëson me autorizim N.M. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K... "E..." me seli në Prishtinë, që e përfaqëson me autorizim V.B., për kompensim të dëmit nga auto përgjegjësia, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse, me dt.20.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesë padia e paditësit B.X. nga fshati..., ndërsa ne tërësi aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.R. nga fsh..., komuna Skenderaj.

II. DETYROHET e paditura K... "E..." me seli në Prishtinë që paditësve B.X. dhe L.R. t'iu kompensojë dëmin të cilin e kanë pësuar me dt.14.01.2020 në Skenderaj ne Rr..., me fajin e vetëm të siguruarit të paditurës G.Q. i cili gjatë drejtimit të automjetit të tipit VW Golf nga pakujdesia ka shkaktuar aksident të komunikacionit, dhe atë ne shumat si në vijim:

Paditësit **B.X.**

Dëmi jomaterial

Për dhimbje fizike, shumen prej 1,800 euro;

Për friken e përjetuar, shumen prej 1,400 euro.

Dëmi material

Për ndihmën e huaj, shumën prej 100 euro;

Për ushqimin e përforcuar, shumen 150 euro.

Gjithsejtë 3,450 euro.

Paditëses **L.R.**

Për dëmin material ne automjetin e tipit "Ford Fokus" me targa te regjistrimit..., shumën prej 6,662 euro.

Gjithsejtë për të dy paditësit ne shumen e përgjithshme prej 10,112.00 (dhjetëmijë e njëqind e dymbëdhjetë) euro, qe duhet te paguhen me kamatë ligjore ne normën prej 8% për demin jo material nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi me dt.20.02.2024 ndërsa për demin material nga data e ushtrimit te padisë me dt.24.02.2020.

III. OBLIGOHET e paditura qe paditësve t'iu paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për hartim te padisë 156 euro, taksë për padi 100 euro, për dy ekspertiza mjekësore 400

euro, për ekspertize të komunikacionit 150 euro, për ekspertize të makinerisë 200 euro, për përfaqësim të avokatit në 5 seanca nga 202 euro shumen prej 1010 euro, për precizim të padisë 156 euro, gjithsejtë shpenzime në shumen prej 2,172 euro.

Shumat e gjykuara për të dy paditësit së bashku në shpenzimet e procedurës duhet të paguhen në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

IV. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë për paditësin B.X. përtej shumave të gjykuara si në par. II dhe III në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe në tërësi kërkesa për pagesën e shpenzimeve për shërim klimatik dhe për shërim me barna në mungesë të provave materiale.

Arsyetim

Paditësi përmes përfaqësuesit me autorizim me dt.24.02.2020 ka ushtruar padi në gjykatë me të cilin ka theksuar se me dt.14.01.2020 në Skenderaj në Rr... ka ndodhur një aksident i trafikut ku janë përfshirë dy automjete me targa... që e ka drejtuar G.Q., dhe automjeti me targa... të cilin e ka drejtuar paditësi B.X. Në këtë aksident është shkaktuar dëm material me të dy automjetet, ndërsa paditësi ka pësuar lëndime trupore si drejtues i automjetit. Aksidenti ka ndodhur nga lëshimet ekskluzive të drejtuesit të automjetit G.Q. i siguruar të e paditura i cili gjatë drejtimit të automjetit nga pakujdesia nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës. Prandaj mbi këtë bazë konform dispozitave ligjore të LMD-së i propozoi gjykatës që pas nxjerrjes së provave të aprovoj padinë dhe paditësit ti kompensoj demin jo material dhe material me kamatën ligjore në normën prej 8 %. Për të dëshmuar demin e pësuar gjykatës i ka bashkangjitur raportet mjekësore dhe raportin e aksidentit.

Në seancën përgatitore të mbajtur me dt.21.06.2023 i propozoi gjykatës aprovimin e ndryshimit -zgjerimit të padisë në aspektin subjektiv me paditësen L.R. nga fshati..., ngase sipas raportit të aksidentit nr.2020-BR-033 dt.14.01.2020, automjeti i përfshirë në aksident me targa... që e ka drejtuar paditësi është në pronësi të L.R.. I propozoi gjykatës nxjerrjen e provës me ekspertize të komunikacionit për të konstatuar rrethanat dhe faktorët që kanë ndikuar në shkaktimin e tij, provës me ekspertize mjekësore Dr.Xh.S. ortoped traumatolog dhe Dr. N.M. psikiatër për të konstatuar natyrën e lëndimeve dhe formave tjera për paditësin B.X. si dhe nxjerrjen e provës me ekspertizë të makinerisë për vlerësim të demit në automjet të paditëses nga eksperti B.L.

Pas nxjerrjes së këtyre provave paditësit përmes përfaqësuesit me autorizim e precizoi kërkesëpadinë me parashtresë të dt.13.12.2023, ku për paditësin B.X. për dhimbjet fizike kërkoi shumen prej 3000 euro, për friken e përjetuar 2500 euro, për ndihmën e personit të tretë 200 euro, për ushqimin e përforcuar 150 euro, për rehabilitim klimatik 230 euro, gjithsejtë 6080 euro, ndërsa për paditësen L.R. për demin material në automjet shumen konstatuar me ekspertizë të makinerisë dhe plotësim të saj në lartësi 6,662 euro.

I kërkoi shpenzimet e procedurës kontestimore, për padi 208 euro, për çdo seancë nga 270 euro, për parashtresë 208 euro, për ekspertizë mjekësore të komunikacionit dhe të makinerisë sipas pagesave të kryera me fatura në shkresat e lëndës.

E paditura me përgjigje në padi të dt.19.12.2022, u deklarua se e konteston pjesërisht kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, për arsye se paditësi ka qenë i obliguar që palës së paditur të ia dërgoj me padi edhe provat tjera me të cilat do të vërtetohej fajësia apo pafajësia e shkaktarit të aksidentit si dhe lartësia e kërkesëpadisë. E paditura sipas shkresave të lëndës e ka trajtuar kërkesën në procedure të rregullt administrative dhe sipas raportit të aksidentit, ka ndarje të përgjegjësisë në mes automjeti (A) dhe (B) 70 -30%.

Gjate seancës përgatitore u deklarua se mbetet pran përgjegjës ne padi nuk e kundërshtoi nxjerrjen e provës me ekspertize te komunikacionit nga eksperti S.B.

Gjate shqyrtimit kryesor e kundërshtoi ekspertizën e komunikacionit te dt.27.06.2023 te nxjerrë nga eksperti S.B. me pretendimin se ne mes të pjesëmarrësve ne aksident te trafikut ka përgjegjësi te ndarë ndërsa eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka dhënë kontribut ne shkaktim te aksidentit andaj propozoi nxjerrjen e një prove ne ekspertize te komunikacionit. Ekspertizën e eksperteve mjekësor te dhënë nga Dr. Xh.S. ortoped - traumatolog dhe Dr. N.M. psikiatër nuk e kundërshtoi. Në ekspertizën e makinerisë për vlerësim te demit ne automjet dhe plotësimin e kësaj ekspertize nga eksperti B.L. pati vërejtje por nuk kërkoi sqarime nga ana e ekspertit.

Ne seancën e shqyrtimit kryesor me dt.05.02.2024, u deklarua se mbetet pranë kundërshtimeve te mëparshme gjersa ne fjalën përfundimtare u deklarua se baza juridike e kërkesëpadiës është vërtetuar me ekspertize te komunikacionit nga Rr.S. i cili ne elaboratin e tij ka sqaruar se automjeti B e ka tejkaluar shpejtësinë e lëvizjes ne momentin e aksidentit gjë te cilin nuk e ka bere eksperti S.B. andaj mbi ketë baze kërkoi nga gjykata qe përgjegjësia te llogaritet e ndare 70% me 30%. Sa i përket demit material dhe precizimit duke marre parasysh përgjegjësinë e paditësve ne ketë aksident shumat e kërkuara janë ne kundërshtim ne natyrën e lëndimit trupor dhe pasojat e mbetura te paditësit, ne dispozitat ligjore te nenin 183 te LMD-së dhe se fundmi Udhëzuesin e Gjykatës Supreme lidhur me Lartësinë e Dëmeve Jo Materiale te Shkaktuara ne Aksident Trafiku me dt.14.01.2023. Sa i përket demit material për ndihmën dhe kujdesin e huaj ushqimin e përforcuar dhe rehabilitim i propozoi gjykatës te aprovojë shumen te cilat janë te argumentuara me fatura dhe kupon fiskal, duke marre për bazë ndarjen e përgjegjësisë, ne te kundërtën te refuzojë kërkesëpadiës sa i përket kategorisë se këtij demi. Sa i përket demit material ne automjet i propozoi gjykatës qe te merr për baze mendimin e ekspertizës se komunikacionit te hartuar me dt.13.10.2023, ku për baze i njëjti ka marre dudin doganor për përcaktim te vlerës se automjetit andaj konsiderojmë se nuk ka qene e nevojshme qe te behet plotësimi i ekspertizës me referencat e çmimit te automjetit sipas tregut ku ne shkresat e lendes ndodhet dudi doganor i cili ka përcaktuar vlerën e tregut te automjetit, ku edhe për te njëjtin çmim janë paguar bazat doganore akciza dhe TVSH për vlerën e kompensimit 5205 euro. Sa i përket shpenzimeve te procedurës për seancat e mbajtura te ja njoh shumen nën 10,000 euro pasi qe nuk janë plotësuar kushtet për aprovimin e shpenzimeve mbi ketë shumë dhe gjykata për shpenzime te vendos bazuar ne nenin 452 par. 2 te LPK-së sipas suksesit ne procedurë pasi qe konsiderojmë se paditësit pjesërisht kanë arritur sukses ne procedure. Kërkoi nga gjykata qe shpenzimet për parashtrësat e rregullimit te padisë te refuzohen pasi qe janë pjese përbërëse te padisë si dhe kohen e llogaritjes se kamatës prej 8% pasi qe e paditura qe nga fillimi i shqyrtimit i ka ofruar mundësi paditësve qe kontestin ta zgjedhin ne pajtim jashtëgjyqësor por nuk kanë pranuar andaj kërkoi që vendimin për kamatën ta nxjerr nga dita e marrjes se aktgjykimit.

Gjykata me qellim te konstatimit te drejte dhe te plote te gjendjes faktike ne çështjen konkrete juridike ne kuptim te nenit 7 dhe 8 te LPK-së i nxori dhe i administroj te gjitha provat e propozuara te palëve ndërgjyqëse te evidentuara ne procesverbalet e seancave te shqyrtimit kryesor dhe ne seancën e fundit kryesore me dt.05.02.2024 një nga një dhe te gjitha se bashku duke i krahasuar njëërën me tjetrën nga te cilat rezulton se kërkesëpadia e paditësit B.X. është pjesërisht e bazuar, ndërsa kërkesëpadia e L.R. është ne tërësi e bazuar.

Ne baze te referatit te padisë dhe raportit të aksidentit nr.2020-BR-033 dt.14.01.2020, konstatohet se në Skenderaj në rrugën... ka ndodhur aksident i trafikut rreth orës 20.00 ne te cilin janë përfshirë dy automjete. Automjeti i tipit VW Golf me targa te regjistrimit..., te cilin e ka drejtuar G.Q. nga Mitrovica i siguruar me polic valide te e paditura dhe automjeti i tipit "Ford Focus" me targa te regjistrimit... te cilin e ka drejtuar paditësi B.X..

Për te konstatuar rrethanat dhe faktorët që kanë ndikuar në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit është nxjerr prova me ekspertizë të komunikacionit nga eksperti S.B. i cili me dt.29.06.2023 gjykatës i ka dorëzuar mendimin dhe konstatimin me shkrim dhe në seancën e dt.05.02.2024, ka dhënë sqarime në këtë ekspertizë.

Eksperti pas marrjes së të dhënave kryesore për pjesëmarrësit e aksidentit, pasojat e aksidentit, shënimet mbi rrugën kohën dhe sinjalizimin e ka bërë analizën e aksidentit ku ka konstatuar se nga ana e policisë janë të njohura këto gjurme teknike dhe biologjike: Nuk ka gjurmë të bartjes - të dukshme para aksidentit për asnjërën nga automjetet në rrugë. Pika e goditjes: PG1 është specifikuar në skicë sipas analizave është kontakti i automjetit "A me automjetin B" në shiritin e djathtë shikuar nga automjeti "B (mesi i shiritit të djathtë). Vendi i ngjarjes së paraqitur në raportin e aksidentit dhe skicë. Trajektorja e lëvizjes së automjetit (A dhe B) sipas përshkrimit të policisë. Pozitat përfundimtare të automjeteve nga pika 0 kontaktit janë automjeti "A 10 m në rrugë dhe automjetin B" 12m jashtë rrugës.

Eksperti pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, shikimit të bazës ligjore për rastin konkret sipas ligjit të rregullave të trafikut rrugor nr.05/L088 ka ardhur deri te mendimi dhe konstatimi përfundimtar se sipas gjurmëve, pozitive përfundimtare, shikimit të vendit të ngjarjes, duke llogaritur dhe simuluar ngjarjen edhe me Softwer përkatës (VCRASH etj., konstatoi se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur si pasojë e ngasësi i automjetit "A" gjatë hyrjes në udhëkryq (gjatë kycjes në rrugë kryesore) në udhëkryq që lidh rrugën urbane nivelin 1 dhe 2, duke mos i respektuar shenjat mbi përparësinë e kalimit e ka goditur automjetin "B. Ngasësi "A" pa u bindur me parë se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik ka vepruar duke shkakuar aksident komunikacioni.

Ngasësi i automjetit "A" ka lëvizur në rrugë dytësor dhe ka qellim që të kycet në rrugë kryesore urbane në udhëkryq duhet të marr veprim vetëm nëse ekzistojnë kushtet e mjaftueshme në këtë rast automjeti "A" nuk ka pasur përparësi kalimi është dashur të pres para shenjës "STOP" derisa të kalojë automjeti "B" nga krahu i majte. Ngasësi "A" ka pasur mundësi të perceptoj ardhjen e automjetit "B" nga krahu i majte në distancë në 30m (dritat e ndezura, rruga e drejt etj.) por e ka neglizhuar rrezikun. Ngasësi i automjetit "B" ka qarkulluar në shiritin e tij të komunikacionit, ka lëvizur në rrugë me përparësi kalimi, nuk ka frenuar, ka lëvizur me shpejtësi rreth 40 Km/h (në zonën e kufizuar 50 Km/h) nga konstatoi se ngasësi i automjetit "B" me veprimet e tij dhe me shpejtësi nuk ka kontribuar në aksident, ndërsa automjeti "A" respektivisht ngasësi i tij me lëshimet e tij janë sepse nuk i ka dhënë përparësi kalimi automjetit "B", kycje e pasigurt nga rruga kryesore (shenja Stop) në rrugën kryesore kështu që drejtuesi i automjetit "A" G.Q. është shkakuar i aksidentit ndërsa B.X. drejtuesi i automjetit "B" nuk ka dhënë kontribut të aksidentit.

Pala e paditur e kundërshtoi edhe me tutje ekspertizën e komunikacionit me arsyetim se nuk është e bazuar për faktin se ka përgjegjësi të ndarë, dhe me propozimin e të paditurës është nxjerrë prova me ekspertizë të komunikacionit nga eksperti Rr.S. me dt.30.11.2023 i cili ka dhënë sqarime në ekspertizë në seancën kryesore me dt.13.12.2023.

Në mendimin dhe konstatimin e tij eksperti ka sqaruar se ekspertizën e ka mbështet në provat në shkresat e lëndës dhe ka bërë këqyrjen në vende ngjarje dhe mbi bazën e tyre fakteve rezulton se aksidenti ka ndodhë në Skenderaj në rrugën... në kryqëzimin me rrugën dytësore... me dt.14.01.2020. Aksidenti ka ndodhë në orën 20 në kohë nate dhe rruga ka qenë e ndriçuar me drita Neoni.

Pjesëmarrës në aksident janë automjeti tipit VW "Golf" nën "A" që e ka drejtuar G.Q. i cili nuk ka qenë i kujdesshëm dhe me të arrit afër kryqëzimit të rrugës me rrugën kryesore... në vendin afër Çerdhës së fëmijëve kycet në mënyrë të pasigurt duke mos respektuar shenjen vertikale "Stop" dhe në kycje e sipër e godet automjetin "B" që qarkullonte rrugës... me përparësi kalimi duke goditur automjetin "B" në pjesën e përparme të anës së djathtë në shiritin e djathtë.

Në faqen tre të ekspertizës janë paraqit fotot e automjetit të dëmtuar dhe në vazhdim pozicioni i automjeteve të përfshira në aksident të komunikacionit.

Eksperti edhe në seancën e shqyrtimit kryesor nuk e ndryshoi mendimin dhe konstatimin e tij se shkaktar kryesor i aksidentit të komunikacionit ka qenë shoferi i automjetit “A” i markës VW “GOLF” me lëshimet e tij mos respektimi i përparësisë së kalimit në udhëkryq i rregulluar me shenja të komunikacionit “Stop” të cilat rregullojnë përparësinë e kalimit në udhëkryq. Nuk i ka dhënë përparësi kalimi automjetit “B” të markës “Ford Fokus” i cili ka qarkulluar në rrugë me përparësi kalimi,

Sipas ekspertit shoferi i automjetit “B” i markës “Ford Fokus” i ka dhënë kontribut në lartësinë e pasojave të aksidentit ngase ka lëvizur me shpejtësi prej 62 km/h , në vendin ku shpejtësia e lëvizjes në atë pjesë të rrugës është e kufizuar prej 40 km h.

Gjykata me vëmendje i analizoi dhe vlerësoi dy ekspertizat e komunikacionit të dhëna nga ekspertet e përmendur më lartë të cilat kanë përfundime të ndryshme sa i përket përgjegjësisë së pjesëmarrësve në aksident të komunikacionit. Ekspertizës së dhënë nga eksperti S.B. gjykata i fali besimin e plotë të provës së besueshme ngase eksperti me argumente të bazuara profesionale ka sqaruar se në vend ngjarje policia nuk ka konstatuar se ekzistojnë gjurmë të bartjes së automjeteve teknike apo biologjike dhe në përshkrimin e pikës së goditjes është brenda shiritit të djathtë të lëvizjes së automjetit “B” si dhe pozicioni i mbetjes së automjeteve, gjykata është bindë në konstatimin e ekspertit S.B. prandaj e mori si provë vendimtare për caktim të përgjegjësisë së pjesëmarrësve në aksident komunikacioni.

Ekspertizës së komunikacionit të dhëna nga eksperti Rr.S. gjykata nuk i fali besimin ngase eksperti nuk e bindi gjykatën se në bazë të cila prova ka konstatuar se shoferi i automjetit “B” ka lëviz mbi shpejtësinë e lejuar në vendin e aksidentit kur shihet se kane munguar provat me rendësi si janë gjurmët teknike dhe biologjike të bartjes së automjeteve. Prandaj nuk është e besueshme konstatimi i ekspertit se edhe drejtuesi automjetit “B” ka kontribuar në shkaktim të aksidentit dhe lartësinë e pasojës, ngase duke i marrë parasysh faktin se drejtuesi i automjetit “B” ka lëvizë brenda shiritit të tij qarkullues, në rrugë me përparësi kalim në përputhje me rregullat sipas shenjave në rrugë e në përputhje me Ligjin Për Trafikun Rrugore rezulton se ekspertiza e ekspertit Rr.S. nuk është provë e besueshëm për gjykatën që konstaton përgjegjësi të ndarë në mes të pjesëmarrësve në aksident komunikacioni.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar si rezultat i provave të administruara gjykata konstatoi se fajtor i vetëm në shkaktim të aksidentit të komunikacionit në rastin konkret është i siguruari i të paditure – drejtuesi i automjetit “A” G.Q.

Për konstatim të natyrës së lëndimeve trupor dhe pasojave tjera për shëndetin e paditësit B.X. është nxjerrë prova me ekspertizës mjekësore nga ekspertet Dr. Xh.S. ortoped - traumatolog dhe Dr. N.M. psikiatër, të cilët në seancën e shqyrtimit kryesor me dt.06.11.2023 pas vlerësimit të raporteve mjekësore në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit ë drejtpërdrejtë të paditësit kanë dhen këtë mendim dhe konstatim;

Paditësi në aksidentin e komunikacionit me dt.14.01.2020 ka pësuar ndrydhje të kokës, dhe të trupit. Lëndimet karakterizohen si lëndime të lehta trupore të cilat kanë shkaktuar:

Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 15 minuta.

Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve.

Dhimbje fizike të intensitetit mesatar 10 ditë, kohë e nevojshme për rikuperim të organizmit për lëndimet e lehta të kokës, trupit dhe qafës të përjetuara në këtë aksident.

Dhimbjet fizike të intensitetit të ulët sipas bashkëbisedimit me paditësin manifestohen edhe sot e kësaj dite si dhembje koke të shprehura në ndryshimet klimatike.

Duke marrë për bazë mendimin e ekspertit mjekësorë i cili konstatoi natyrën e lehtë të lëndimeve trupore intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, gjykata e aprovoi shumën prej 1,800 euro e cila është e përafërt me dëmin e pësuar.

Paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe as shëmtim trupor.

Sipas ekspertës mjekësorë paditësi në aksident ka përjetuar këto lloje të frikës:

Frikë primare në momentin e aksidentit në formë të frikës nga kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritetin e tij fizikë e cila ka zgjat disa sekonda.

Frikë sekondare e intensitetit të lartë që ka zgjatuar 24 ore, e shoqëruar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit, ankeve të herë pas hershme, shqetësimeve gjatë gjumit si dhe rikujtim të ngjarjes traumatike.

Frikë sekondare të intensitetit të mesëm paditësi ka përjetuar 2 javë, e manifestuar me gjendje të reaksionit akut ndaj stresit shoqëruar me koke dhimbje të herë pas hershme, shqetësime gjatë gjumit, nervozë dhe in disponim, për çka paditësi është konsultuar edhe me psikiatër që i ka përshkruar terapi adekuate qetësuese.

Frikë sekondare të intensitetit të ulët, ka vazhduar të ketë edhe për 2 muaj periudhë kjo e rikuperimit nga pasojat e lëndimit të lehtë fizik shoqëruar me shqetësime të herë pas hershme të gjumit, in deponimit, nervoz dhe pasigurisë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Gjykata duke marrë për bazë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga paditësi si pasojë e aksidentit e aprovoi shumën prej 1400 euro, e cila shumë është proporcionale me dëmin e pësuar.

Sipas ekspertit mjekësor paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 10 ditëve, e cila ka konsistuar në përgatitje të ushqimit dhe ndihmat tjera të nevojshme ditore gjatë kësaj periudhe, kështu që gjykata e ka aprovuar shumën prej 100 euro.

Paditësi ka pasur nevojë për ushqimin e përforcuar të pasur me minerale, vitamina, proteina në raport me ushqimin e rëndomtë për rikuperim me të shpejtte të lëndimeve trupore, kështu që gjykata duke marrë për bazë kriteret plotësuese për këtë formë të dëmit e aprovoi shumën prej 150 euro.

Pas vlerësimit gjykata e mori si provë të besueshme mendimin edhe konstatimin e ekspertëve mjekësorë ngase konstatimin e kanë dhënë në mënyrë të drejtë dhe ekspertiza përmban të gjitha kriteret e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale të ekspertëve prandaj gjykatës i shërben si provë vendimtare për natyrën e lëndimeve trupore dhe llojeve tjera të dëmit.

Për sa i përket bazës së përgjegjësisë për shpërblim të dëmit gjykatat i zbatoi dispozitat e nenit 136 paragrafi 1 i LMD-së nr.04/L-077 ku shprehimisht është përcaktuar *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar për fajin e tij”*. Lidhur me dëmit jo material dhe shumave të aprovuar gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 183 paragrafi 1 i LMD-së ku shprehimisht është përcaktuar *“Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*.

Gjykata sipas detyrës zyrtare ne përputhje me dispozitat e nenit 183 paragrafi 2 të LMD-së për demin jo material është kujdesur për te mirën e cenuar nga akti dëmtues dhe qëllimit qe i shërben ky shpërblim i cili është plotësisht në pajtueshmëri me të mirën e cenuar paditësit nga veprimi dëmtuesi i të paditurës.

Ne ketë aksident te komunikacionit dëm material ne automjet te tipit “Ford focus” me targa te regjistrimit..., ka pësuar paditësja L.R. automjet te cilin ne momentin e aksidentit e ka drejtuar paditësi. Për te konstatuar lartësinë e demit ne automjetin e përmendur gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertize te makinerisë nga eksperti B.L.

Eksperti pas analizimit dhe vlerësimit dhe dokumentacionit ne shkresat e lendes te dhëna teknike për automjetin, konstatimin e demit nga raporti policor nr.2020-BR-033 dt.14.01.2020, e dha mendimin dhe konstatimin me shkrim me dt.08.11.2023 se ne automjet është shkaktuar demi i konsiderueshëm dhe i njëjti pas riparimit nuk garanton kthim ne gjendje – para aksidentit dhe qarkullim te sigurt ne komunikacion, pasi qe janë dëmtuar pjesët vitale te automjetit dhe si te tille demi i shkaktuar ne automjet konsiderohet “dem total teknik, ekonomik”. Ne fund te ekspertizës ne mënyre tabelore janë paraqitur pjesët e dëmtuara dhe vlera e tyre kështu qe eksperti ne fund ka ardhur ne mendim dhe përfundim, se demi i shkaktuar ne automjet është “dëm total, teknik, ekonomik”, në vlerë prej 5,205.48 euro. Eksperti ka sqaruar se deri te ky çmim përfundimtar përveç vlerës se automjetit te dëmtuar është hulumtuar edhe DUD-I (dokumenti unik doganor) i automjetit te dëmtuar, i cili është doganuar ne Kosovë me dt.28.12.2019 apo rreth 18 dite para aksidentit.

Ketë ekspertizë e kundërshtoi përfaqësuesi i palës paditëse me arsyetim se nuk janë marrë për bazë, librat evropiane qe janë ne kompani te sigurimit për vlerësim te demit qe e ka konstatuar eksperti por është mbështetur vetëm ne Dudin doganor.

Për këto arsye gjykata e obligoi ekspertin qe ta plotësoj ekspertizën pas hulumtimit edhe ne librat përkatëse evropiane te vlerësimit, te demit ne automjet.

Eksperti me dt.21.12.2023, i ka dorëzuar gjykatës plotësimin e ekspertizës dhe ka dhënë sqarime ne seance kryesore me dt.05.02.2024. Ne plotësimin e ekspertizës ka sqaruar se e ka bere rikualifikimin e vlerësimit te demit ne automjet duke përdorur katalogun e tanishëm evropian, ashtu qe mendimi plotësues është i bazuar ne auto katalogun evropian te automjeteve “AUDATEX” i njëjti nuk posedon vlere momentale te tregut për automjetin e dëmtuar. Duke marrë për baze qe ato – katalogje “AUDATEX” nuk posedojnë vlere momentale për ketë lloj dhe tip te automjetit te dëmtuar, për te përcaktuar vlerën reale te tij është marrë si reference, auto tregu vendor. Automjeti i dëmtuar ne kohen e ndodhjes se aksidentit ka qene ne përdorim 8 vite. Ne kohen e tanishme për vlerësim duhet te merret i njëjti tip dhe model i automjetit me vjetërsi rreth 8 vite apo viti i prodhimit rreth vitit 2015. Vlera mesatare e përafërt ne auto treg vendor te automjetit te dëmtuar e hulumtuar ne web faqe te ndryshme te auto tregut ne Republikën e Kosovës (merr jep, veturash ne shitje etj.) varion. Vlera e përafërt e tregut e automjetit te dëmtuar ne ditën e sotme (për automjetet e te njëjtit tip dhe model me vjetërsi 8 vite është paraqitur në dy foto të marra nga auto tregu në shumat 7500 dhe 8950 euro. Eksperti ne përfundim te plotësimit te ekspertizës ka konstatuar se vlera mesatare e automjetit (ne auto tregun vendor) është prej 8.225 euro. Vlera e pjesëve te mbetura (19%), është 1,562 euro kështu qe vlera e demit ne automjet është ne shumen e përgjithshme 6.662.25 euro.

Ndaj plotësimit te ekspertizës pala paditëse është deklaruar pa vërejtje ndërsa e paditura e kundërshtoi ekspertizën e vlerësimit të demit ne automjet dhe plotësimin e saj.

Gjykata e vlerësoi ekspertizën e makinerisë dhe plotësimin e saj, si dhe sqarimet e dhëna nga eksperti ne seancë kryesore kështu qe ekspertiza merret si prove e besueshme, ngasë i përmban te gjitha kriteret e nevojshme vlerësuese te dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe përvojës se ekspertit ne fushën përkatëse, prandaj gjykata e morri si provë vendimtare mbi bazën e se cilës është konstatuar lartësia e demit material ne automjet te cilën shume gjykata e aprovoi si te drejtë.

Sa i përket demit material për kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar janë zbatuar dispozitat e nenit 179 paragrafi 1 i LMD-së ndërsa sa i përket, demit material ne automjet janë zbatuar dispozitat e nenit 169 paragrafi 3 i LMD-së.

Me provat e administruara gjykata ka vërtetuar se e paditura është e detyruar qe paditësve t’iu kompensojë demin jo material dhe material ne shumat e gjykuara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, ngase me shkaktarin e aksidentit – te siguruarin e saj ka lidhur kontrate me te cilën ka marrë përsipër kompensimin e demit qe shkaktohet nga auto përgjegjësia konform dispozitave të nenit 9 par 1 të LSDA nr.04/L-018. Shumat e gjykuara janë ne pajtueshmëri te plote me demin qe e kane pësuar paditësit dhe do t’iu shërbej si satisfaksion real për plotësimin e nevojave te tyre nga akti dëmtues.

Është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave te gjykuara për te gjitha kategoritë zhdëmtuese si të larta në raport me demin dhe praktikat gjyqësore dhe në tërësi është refuzuar kërkesa për rehabilitim klimatikë banjorë dhe kërkesa për kompensimin e shërimit me barna, kjo në mungesa të provave materiale se janë paguar këto shërbime për shërim të paditësin B.X..

Është refuzuar pjesa tjetër e kërkuar sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, pasi që shuma e kërkuar nuk është në përputhje me Tarifën e Odës së Avokatëve.

Gjykata i vlerësoi te gjitha kundërshtimet e palës se paditur, te paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ne fjalën përfundimtare përmes të cilave kërkojnë nga gjykata qe sa i përket bazës juridike ti fale besimin e ekspertizës se komunikacionit te punuar nga eksperti Rr.S. i cili ka konstatuar se automjeti “B” ka kontribuar ne shkaktim te aksidentit duke lëvizur me shpejtësi mbi atë te lejuar ne vendbanim, ashtu qe përgjegjësia ne mes te pjesëmarrësve te llogaritet me 70 me 30%. Sa i përket demit material dhe precizimit të për ketë kategori, me ç’rast kërkuar nga gjykata qe te merr për bazë ndarjen e përgjegjësisë ngase shumat e kërkuara janë te larta sepse lëndimet janë te natyrës se lehte trupore, dhe te merret për baze dispozita e nenit 183 te LMD-së dhe udhëzuesi i Gjykatës Supreme nr.265/2020 dt.02.12.2020. Sa i përket demit material për kujdes të huaj dhe ushqimin e përforcuar si dhe rehabilitimin klimatik ku i propozuan gjykatës qe te aprovet ne baze te provave materiale qe e dëshmojnë ketë dëm. Për demin material ne automjet të merr për baze mendimin e ekspertit te komunikacionit te dhënë me dt.13.10.2023, duke vlerësuar se nuk ka qene e nevojshme te behet plotësimi i ekspertizës se demit ne automjet ngase ne shkresat e lendes gjendet Dudi doganor i cili qarte dhe saktë ka caktuar vlerën e automjetit kështu qe për te njëjtin çmim janë paguar baza doganore, prej 5205 euro duke marre për baze përgjegjësia e ndare e paditura duhet te paguaj shumen prej 3642 euro. Sa i përket shpenzimeve te procedurës për seancat e mbajtura te janë njeh kompensimin nën vlerën 10,000 euro, dhe ti zbatoj dispozitat e nenit 452 paragrafi 2 te LMD-së. Gjykata edhe pas vlerësimit te kundërshtimeve te paditurës ka gjete se ato janë pjesërisht te bazuara sa i përket demit jo material dhe material për paditësin B.X., ndërsa kundërshtimet tjera qe kanë te bëjnë me ndarje te përgjegjësisë lartësinë e demit material ne automjet dhe për shpenzimet e procedurës nuk janë provuar me fakte dhe prova kështu qe nuk janë nen ndikim qe te vendoset ndryshe nga ajo qe u vendos ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Vendimi qe e paditura është e obliguar ti kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumat si ne dispozitiv te aktgjykimit është i bazuar ne dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së.

Vendimi qe e paditura shumat e gjykuara ti paguaj me kamatën ligjore ne normën prej 8 % për demin material nga dita e marrjes se aktgjykimit me dt.20.02.2024, ndërsa për demin material nga data e ushtrimit te padis me dt.26.02.2020 është i bazuar ne dispozitat e nenit 382 te LMD-së dhe mendimin juridik te Gjykatës Supreme nr.265/2020 dt.02.12.2020.

Me sa u tha më lartë konform dispozitave materiale të cituara më lartë dhe dispozitave të nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA NË SKENDERAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM.
C.nr.141/2020, me dt.20.02.2024**

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.